



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në  
“Psikologji e Aplikuar” me profile, “Psikologji Klinike”,  
“Psikologji Shkollore”, “Psikologji Këshillimi”, “Psikologji  
Organizionale”, “Menaxhim dhe vlerësim projektsh”,  
i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i  
Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc. Dr. Artemisi Shehu

2. Dr. Esmeralda Ismaili


Janar/2020



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Institucioni i arsimit të lartë Universiteti European i Tiranës (UET), është hapur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 636, datë 20.09.2006. UET është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009. Në vitin 2017, është miratuar Statuti i Institucionit në përputhje me Ligjin 80/2017 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, Universiteti European i Tiranës ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë, QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022. UET përbëhet nga 5 Fakultete, 11 Departamente dhe 4 qendra kërkimore.

Objekt i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit të ciklit të dytë, “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore”, “Psikologji Këshillimi”, “Psikologji Organizacionale”, “Menaxhim dhe vlerësim projektsh”. Njësia bazë që ofron programin e studimit është Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Ky program rrjedh nga riorganizimi në masën mbi 20%, i programit të studimit “Master Profesional” në “Psikologji Shkollore”, në bazë të Urdhrit të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 662, datë 12.10.2018.





## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM; 200 FJALË

Hartimi i raportit të Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, u përpilua nga dy ekspertë me përvojë në fushën e mësimdhënies dhe profesionin e psikologjisë, Prof. As. Artemisi Shehu dhe Dr. Esmeralda Ismaili, si dhe me asistencën e përfaqësueses së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Emisa Isufaj. Ekspertët e përzgjedhur për t’u përfshirë në vlerësimin e këtij programi studimi janë miratuar nga ASCAL me anë të Urdhrit Nr. 83, datë 16.10.2019.


Grupi i ekspertëve të vlerësimit ka konsideruar të gjitha dokumentet e përfshira në DVV si dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitës në institucion për të përpiluar këtë raport vlerësimi. Po ashtu, grupi është konsultuar edhe me kuadrin ligjor, ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, ekspertët kanë konsultuar me njëri-tjetrin të gjitha gjetjet dhe konkluzionet që janë prezantuar në këtë raport, si dhe kanë dakordësuar bashkërisht për vlerësimin e standardeve. Me qëllim dhënien e një vlerësimi sa më objektiv për plotësimin e standardeve ka qenë një proces sa matematikor po aq dhe i bazuar në peshën që ka plotësimi i kriterit në garantimin e cilësisë për programin e studimit.

Më datë 08.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 9/1 Prot., dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 14.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë Nr. 06/2, datë 15.01.2020, “Komente në lidhje me draft raportin e GVJ për programin Master profesional “Psikologji e Aplikuar” ”.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi draft-Raportin të paraqitura sipas fushave, shprehet si vijon:


- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.3, Kriteri 1**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.3, Kriteri 3**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.3, Kriteri 6**, GVJ shqyrtoi evidencat e dërguara nga institucioni në lidhje me punimet/detyrat e përcaktuara në pesë lëndët që i përkasin profilit psikologji këshillimi dhe psikologji klinike, të cilat nuk ishin vendosur në dispozicion gjatë dorëzimit të DVV dhe mbetet me rekomandimin e shprehur në dokumentin Draft - RVJ që të aplikohet edhe në lëndët e profileve të tjera.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin II.1, Kriteri 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin II.1, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin II.4, Kriteri 5**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ dhe sqaron se vështirësia e transferimit të studimeve të






këtij programi i referohet transferimit të studimeve në një program master shkencor në institucion tjetër në profilin e përzgjedhur.

- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin II.4, Kriteri 6**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.3, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.3, Kriteri 5**, GVJ sqaron se e ka shprehur dhe vlerësuar pozitivisht mundësinë e krijuar nga IAL për stafin akademik dhe studentët për aksesin në libraritë *online* dhe i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.4, Kriteri 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.4, Kriteri 5**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ duke argumentuar se institucioni është në dijeni që të gjithë aktivitetet e ndërmarra shoqërohen me evidenca, sikurse është bërë në të gjithë RVB.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.7, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.7, Kriteri 6**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.7, Kriteri 9**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RV, mbështetur në përmbajtjen e kriterit në fjalë.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.7, Kriteri 10**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.8, Kriteri 1**, GVJ merr në konsideratë komentin e IAL dhe reflekton në RVJ vlerësimin.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.8, Kriteri 2**, GVJ merr në konsideratë komentin e IAL dhe reflekton në RVJ vlerësimin.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.9, Kriteri 1**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.9, Kriteri 6**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.9, Kriteri 9**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV.2, Kriteri 1**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.





- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV.2, Kriteri 3**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV.2, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV.4, Kriteri 2**, GVJ sqaron se e ka shprehur dhe vlerësuar mundësinë e krijuar nga IAL për stafin akademik dhe studentët për aksesin në libraritë *online* dhe i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV.4, Kriteri 5**, GVJ shqyrtoi referencën e dërguar nga IAL, dhe i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ, pasi nuk mund të kuptojë dot nëse kjo listë disponon literaturë që është në mbështetje të këtij programi studimi, sikurse Kriteri 5 e shpreh.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.2, Kriteri 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.2, Kriteri 3**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.2, Kriteri 5**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.3, Kriteri 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.5, Kriteri 1 dhe 2**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.5, Kriteri 3**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.
- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin VI.5, Kriteri 4**, GVJ i qëndron konkluzionit të shprehur në dokumentin Draft - RVJ.





**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË “PSIKOLOGJI E APLIKUAR” ME PROFILE, “PSIKOLOGJI KLINIKE”, “PSIKOLOGJI SHKOLLORE”, “PSIKOLOGJI KËSHILLIMI”, “PSIKOLOGJI ORGANIZACIONALE”, “MENAXHIM DHE VLERËSIM PROJEKTESH”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Vërtetohet se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, është i përshtatur me interesat kombëtare dhe ndihmon në ruajtjen e vlerave shqiptare. Ai është ndërtuar brenda kornizës ligjore për arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë.			
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi mbështetet në misionin e UET, i cili është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare ( <i>Statuti i UET</i> ). Programi synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare, pasi i edukon dhe orienton studentët, krahas vlerave humane dhe me vlerat kulturore kombëtare.			
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Vërtetohet se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji të Aplikuar” me 5 profile, në UET është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e veprimtarisë (sikurse parashikohet edhe në statutin e UET), duke diplomuar studentë që do të shërbejnë në shoqërinë shqiptare përmes dijes së marrë në procesin e mësimdhënies.			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	GVJ nga takimet e realizuar gjatë vizitës konstatoi se programi i studimit është hartuar me qëllim diplomimin e studentëve të cilët përmes dijes së marrë do t’i shërbejnë nevojave dhe dinamikave të zhvillimit të tregut të punës. Programi i studimeve është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, që kërkon një orientim drejt shërbimeve psikologjike, sidomos në institucionet edukative, shëndetësore dhe projekte.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe	Universiteti European i Tiranës ka hartuar dhe vendosur në zbatim



<p>ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Planin Strategjik 2015-2020. GVJ konstaton se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji të Aplikuar” me profile, është në përshtatje me strategjinë e institucionit, duke ju referuar objektivave të këtij programi në dokumentin e rregullores së programit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Konstatohet se në dokumentet bazë të institucionit përcaktohen drejtimit prioritar akademike, të cila përthyhen edhe në këtë program studimi. Më konkretisht, prioriteti mbi kërkimin shkencor që është pjesë e dokumentit të Statutit, Rregullores dhe Planit Strategjik të Institucionit është në përputhje me objektivat strategjikë për zhvillimin e “Master Profesional” në “Psikologji të Aplikuar” me profile, ku synimi është formimi akademik dhe bashkëkohor i studentit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimi “Master Profesional” në “Psikologji të Aplikuar” me profile, ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Konstatohet se struktura dhe organizimi i këtij programi studimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Konstatohet se programi është hartuar në përputhje me prioritetet e institucionit dhe në përshtatje me dinamikat dhe zhvillimet e tregut të punës. Interesat kombëtare garantohej nëpërmjet formimit të profesionistëve të cilët do të kujdesen për mirëqenien psikologjike dhe shëndetin mendor të qytetarëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p><b>Standardi I.3</b> Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar (specifikisht rregullorja e programit) si dhe gjatë takimeve të realizuara, rezulton se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji të Aplikuar” me profile, ka objektiva të shprehura qartësisht, të cilat synojnë të përgatisin studentët me njohuri të thelluara teorike dhe kompetenca profesionale për të ushtruar profesionin e psikologut në një nga pesë profilet e ofruara. Por nga ana tjetër, GVJ pas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve profilizuese të këtij programi konstaton se tre lëndët që diferencojnë profilet në kategorinë C nuk janë të mjaftueshme për të thelluar njohuritë e studentëve në profilin që ata do të përzgjedhin, por e lënë atë në nivelin e njohjes së profilit të zgjedhur.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se ekziston një dokument mbi analizën e tregut të punës bazuar në nevojat e tregut për profesionin</p>



<p>hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>e psikologut dhe mundësitë e punësimit në kontekstin kombëtar. Por, ky studim rezulton të jetë empirik, më shumë sesa i ndërtuar mbi instrumente studimi real dhe mbetet i pjesshëm duke qenë se nuk prezanton nevojat për secilin profil me të njëjtën peshë. Megjithatë, IAL dhe njësia bazë që ofron këtë program studimi demonstroi përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me kërkesat e tregut të punës përmes marrëdhënieve të konsoliduara me UET ALUMNI të punësuar, me takimet dy herë në vit me Bordin e Tregut të Punës, me organizimin e panairit të punës ku ftohen partnerë potencial për punësimin e studentëve, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni dhe njësia bazë janë të angazhuar seriozisht për të mundësuar që studentët e diplomuar të përshtaten në tregun e punës. Megjithatë, lipset që përmbajtja e programit të studimit të rishikohet me synim që studentët të pajisen me aftësi praktike të konsoliduara, që i përgjigjen nevojave të tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Në takimin me dekanen e fakulteti dhe drejtuesin e njësisë bazë u konfirmua se ndryshimet në programin e studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, është formulë e përhapur dhe është aplikuar në të gjitha programet e studimit në rang institucioni. Përzgjedhja e profileve është bazuar kryesisht nga eksperiencia e stafit të seksionit të psikologjisë, ku u veçua eksperiencia nga Universiteti i Sheffild në Selanik, eksperiencia nga një universitet në Gjermani, si dhe eksperiencia e universiteteve italiane. GVJ shprehet se profilet e këtij programi studimi qëndrojnë si specialitete të veçanta me një kurrikul, e cila duhet të jetë më e thelluar me synimin e pajisjes së studentëve me kompetencat e nevojshme për të ushtruar specialitetin e përzgjedhur.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disaveçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni bën përpjekje për të arritur dimensione ndërkombëtare përmes formave të mësimdhënies, metodave të vlerësimit, objektivave, përzgjedhjes së literaturës së huaj nga shtëpi botuese prestigjioze për fushën e psikologjisë, megjithatë programi i studimit mbetet brenda kufijve të arsimit universitar shqiptar, veçanërisht në konceptimin e syllabusit si dhe aktiviteteve akademike të parashikuara modulet.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi synon aftësimin profesional të studentëve. Për këtë arsye studentët e këtij programi në semestrin e dytë kanë të parashikuar si lëndë plotësuese “Praktikë dhe zhvillim karriere” dhe po ashtu njësia bazë ka parashikuar staf akademik, si përgjegjës për supervizionin e praktikave profesionale. Rekomandohet që në syllabuset e lëndëve (ku është e aplikueshme) të parashikohen detyra praktike (aplikime në terren) me qëllim konkretizimin e njohurive dhe aftësimin e studentëve në kontekstin e profilit të zgjedhur prej tyre.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen</p>	<p>Vërtetohet se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, ofrohet në gjuhën shqipe dhe</p>



elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	përfshin të gjithë elementët e parashikuar në kornizën ligjore të arsimit të lartë në R.Sh. Konfirmohet nga takimet se institucioni dhe njësia bazë kanë burimet njerëzore për të ofruar programin në gjuhë të huaj, por në këtë program studimi nuk ka pasur raste të mobilitetit, ardhjes së studentëve të huaj për të zhvilluar studimet në një semestër në UET			
<b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimi të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Bazuar në shqyrtimin e DVV dhe në takimin me grupin e punës, GVJ konstaton se institucioni ruan dhe arkivon dokumentet që lidhen më këtë program studimi si syllabuset, literaturën, shkresat, vendimet, etj., si dhe aktivitete stafit akademik apo ato të realizuar me studentët. Këto dokumente mund të aksesohen edhe elektronikisht përmes sistemit të brendshëm të institucionit, intranet-it.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Konstatohet se institucioni ka eksperiencën e nevojshme, burimet njerëzore dhe kapacitetet fizike për të ofruar këtë program studimi. Institucioni operon që prej 13 vitesh në fushën e arsimit të lartë dhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, nga i cili ofrohet ky program, është themeluar në vitin akademik 2011-2012, kur u licencuan edhe programet e studimit në fushën e psikologjisë dhe edukimit. Në programin e studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, në vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 14 anëtarë si personel akademik, 10 PAE dhe 4 PAK.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Konstatohet përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve.
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese	Referoju kriterit të mësipërm (Kriteri 2). Gjithashtu, konstatohet se ky nuk është një program studimi ndërdisiplinor.



duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.		Ky program studimi nuk qëndron jashtë profilit të institucionit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga shqyrtimi i DVV dhe në takimin me grupin e punës së RVB dhe drejtuesin e departamentit vërehet se institucioni ka procedura të qarta për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë. Më konkretisht, departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve është i ndarë në tre seksione: seksioni i psikologjisë, seksioni i mësuesisë dhe seksioni i sporteve. Mbarëvajtja e këtij programi studimi ndihmohet nga seksioni i psikologjisë. Kështu, drejtuesi i departamentit përcakton përgjegjësit e grupit mësuesor/koordinatorit të programit, të cilët konsultohen së bashku me titullarët e lëndëve për të përmirësuar dhe përditësuar me literaturë të pesë viteve të fundit syllabuset e lëndëve.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësuesor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Referuar dokumenteve në DVV dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës, GVJ iu komunikua se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh homologe kombëtare dhe ndërkombëtare, ku numërohen në total 109 të tilla, nga të cilat 94 me universitete të huaja dhe 15 me universitete vendase, pjesa më e madhe e këtyre marrëveshjeve janë në kuadër të ngritjes së kapaciteteve dhe shkëmbimeve. Këto marrëveshje nuk rezultojnë të jenë në terma specifik për t'i shërbyer realizimit të objektivave të procesit mësuesor të këtij programi studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Gjatë shqyrtimit të RVB por edhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë realizimin e praktikave profesionale. Megjithatë, rekomandojmë të shtohen marrëveshje me institucione të tjera (si p.sh., institute kërkimi), që do të ndihmojnë studentët e pesë profileve të këtij masteri të njihen dhe angazhohen në profilin e përzgjedhur
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton se institucioni zotëron marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat përcaktohet se në cilat prej tyre mund të zhvillohen praktikat profesionale për studentët e këtij



programeve të studimit që ofron.	programi studimi.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në dokumentet e dorëzuara listohen disa trajnime profesionale që institucioni ofron të për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. Megjithatë, rekomandohet që temat e trajnimeve të jenë më përfshirëse për të gjithë profilet që ky program ofron.			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i DVV rezulton se departamenti përgatit një raport me statistika të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe një përmbledhje nga opinionet që studentët kanë dhënë për eksperiencën e tyre në institucionin ku kanë zhvilluar praktikën.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Konfirmohet se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me 5 profile, është i organizuar në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimet e MASR, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Referuar kurrikulës së programit të studimit se rezulton se lëndët janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 60 ECTS.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Vërehet se programi Master profesional në “Psikologji e Aplikuar” ofron pesë profile, të cilat në vetvete përbëjnë specialitete në fushën e psikologjisë si psikologjia klinike, këshillimit, shkollore, organizacionale, ndërsa profili i menaxhimit të projekteve nuk është specialitet i psikologjisë.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Në rregulloren e këtij programi studimi konstatohet se ky program synon të pajisë studentët me njohuri të nevojshme për të ushtruar profesionin e psikologut në drejtime të ndryshme. Megjithatë, GVJ rekomandon se kurrikula duhet rishikuar dhe përmirësuar me qëllim përmbushjen e këtyre objektivave.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se kurrikula e këtij programi studimi mundëson zhvillimin e njohurive dhe aftësive, por është e domosdoshme që ajo të përmirësohet, pasi lëndët që përbëjnë profilet janë shumë të kufizuara për të mundësuar thellimin e studenteve në profilin që do të përzgjedhin.
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Vërtetohet se programi i “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. Programi ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale prej 1 viti akademik ose 2 semestra, ku në secilin semestër përfitohen 30 ECTS. Pas shlyerjes së detyrimeve, studenti pajiset me diplomë “Master Profesional” në një nga 5 profilet e ofruara.
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Konstatohet se në kurrikulën e këtij programi studimi janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese sipas kategorive (A-E), me peshën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL.”). Kështu, në Kategorinë A janë përcaktuar 6 kredite ose 10% (referenca 5-10%),



	në kategorinë B janë parashikuar 18 ECTS ose 30% (referenca 30-40%), në kategorinë C janë parashikuar 18 kredite ose 30% (referenca 20-30%), në kategorinë D janë 6 ECTS ose 10% (referenca 10%), dhe në kategorinë E janë 12 kredite ose 20% (referenca 10-20%).			
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Në këtë program studimi ngarkesa në kredite për praktikën profesionale është 6 ECTS (10%) sipas përcaktimit në aktet nënligjore. Ajo është e shtrirë në një semestër akademik.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Konstatohet se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, që janë përgjegjëse për këtë program studimi zhvillon veprimtarinë në përputhje legjisacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të vlerësimit dhe akreditimit. Në DVV janë vendosur të gjithë aktet ligjore që vërtetojnë legjitimitetin e kësaj njësie për t'u nënshtruar procesit të vlerësimit dhe akreditimit.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, si dhe departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti është i përbërë nga 3 departamente dhe departamenti ka përgjegjësin, koordinatorin e grup lëndëve mësimore, stafin akademik, etj. Po ashtu edhe struktura akademike rezulton e përputhur me aktet ligjore dhe nënligjore, pra janë parashikuar data e fillimit, përfundimit të procesit mësimor, si dhe pushimet zyrtare.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Referuar RVB dhe dokumentacionit mbështetës Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, përbëhet nga Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit dhe në akademik 2018-2019 janë angazhuar 16 anëtarë efektivë nga të cilët 12 me grada e tituj; Departamenti i Arteve të Aplikuara, në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 9 anëtarë, prej të cilëve 7 me grada e tituj, si dhe Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve përgjegjës për këtë program studimi në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 12 anëtarë efektivë, nga të cilët 7 me grada e tituj (2 Prof. Dr., 3 Prof. Asoc. Dr, 2 Dr. dhe 5 me MSc, të cilët janë në raportin PAE/PAK 12/9.



	Po ashtu, raporti personel akademik efektiv/studentë në nivel njësie bazë është brenda normës së përcaktuar në aktet nënligjore, me konkretisht me 1 me 28.								
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Shih komentet në kriterin 2.								
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Nga shqyrtimi i DVV dhe gjatë takimeve konstatohet se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka angazhuar personel akademik për realizimin e praktikës mësimore.								
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga shqyrtimi i DVV konstatohet se dekani i njësisë kryesore, ku ofrohet ky program studimi ka nxjerrë një vendim (Vendim Nr.46, datë 11/11/2019), ku ka emëruar koordinatoren për seksionin e psikologjisë (ciklin e parë dhe të dytë të studimeve).								
<b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	GVJ vërteton se në statutin e institucionit si dhe në dokumentin e organizimit dhe funksionimit të dekanatit dhe departamentit janë përcaktuar qartë detyrat e koordinatorit të programit. Koordinatorin raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek drejtuesi i departamentit ose gjatë mbledhjes së departamenti.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi II.3**

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Konstatohet se njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit kanë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin, strukturën dhe kurrikulën e këtij programi.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Bazuar në dokumentet mbështetëse, GVJ konstaton se ky program studimi është i organizuar në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese, sikurse janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Vërtetohet se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, është i organizuar në lëndë që vlerësohen në kredite ECTS, të ndara në dy semestra, me nga 30 ECTS secili.



<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ konfirmon se programi i studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, është i organizuar sipas një plani mësimor, në cilin specifikohen të gjitha lëndët, ndarjen e tyre në semestra, ECTS, orë në auditor, orë si punë të pavarur, seminare, leksione dhe projekte. Ndërsa në rregulloren e programit të studimit specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni zotëron dokumente të cilat përcaktojnë procedurat dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve për këtë program studimi GVJ konstaton se ato përmbajnë informacion të detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si dhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion, GVJ u komunikua se në çdo vit akademik departamenti bën rishikimin e syllabuseve me inputin e dhënë nga pedagogët e lëndës dhe anëtarët e bordit të tregut të punës. Më tej me mbështetjen e koordinatorit të programit të studimit, ndryshimet miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë. Mbetet e paqartë sesi është procesi i konvertimit i konkluzioneve të dala nga konsultimi i syllabuseve të lëndëve me këtë bord.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Vërtetohet se ngarkesa e këtij programi studimi është strukturuar sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ashtu sikurse parashikohet për studimet master profesional, ky cikël realizohet në brenda një viti akademik, me kohë të plotë dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë 60 ECTS.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose</p>	<p>GVJ konstaton se mënyra e organizimit të këtij programi studimi pajisë studentët me njohuritë e nevojshme në orientimet që ato do të zgjedhin. Megjithatë rekomandohet që këto njohuri të thellohen dhe</p>



punësimin e studentëve.	t'i japin mundësi studentëve të konkurrojnë në tregun e punës duhet të rishikohen dhe përmirësohen disa lëndë dhe syllabuse.								
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Konstatohet se organizimi i veprimtarisë mësimore, si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.								
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Konstatohet se struktura e programit, ngarkesa në kredite është në përputhje me Kartën e Bolonjës.								
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se mund të ketë vështirësi në transferimin e studimeve në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, për shkak të specifikës të këtij programi, i cili është i profilizuar dhe jo me një drejtim specifik në fushën e psikologjisë.								
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	GVJ iu komunikua nga disa burime se përditësimi i lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit është prioritet për institucionin. Konstatohet se në shumicën e syllabuseve është përfshirë literaturë e 5-7 viteve të fundit.								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi konstatohet nevoja e rishikimit të disa prej tyre, me synim përshtatjen me objektivat e formimit të studentëve. Po ashtu edhe nevojitet të rishikohen edhe lëndët që profilizojnë studentët në një nga 5 profilet që ky program ofron.								
<b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Sikurse shprehemi edhe në kriteret e mësipërme nevojitet që të rishikohet përmbajtja e programit të studimit, për t'i dhënë mundësi studentëve të kenë një formim më të thelluar në profilet që ata do të përzgjedhin.								
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Konstatohet se përmbajtja e këtij programi studimi nevojitet të përmirësohet për të nxjerrë studentë që do të konkurrojnë denjësisht në tregun e punës. Diferenca prej tre lëndësh në secilin profil mund të rrisojë përgatitjen e tyre për të qenë konkurrues në tregun e punës.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="542 1601 742 1646">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="742 1601 949 1646">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="949 1601 1157 1646">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1157 1601 1375 1646">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		<b>X</b>		
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	<b>X</b>								

**Standardi II.5**

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Konstatohet se personeli akademik i angazhuar në programin “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, kanë formim akademik, pra gradat shkencore që parashikon legjislacioni në fuqi.			
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, si titullarë të lëndëve apo moduleve janë pedagogë me grada e tituj. Për vitin akademik 2019-2020, në programin e studimit “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, janë angazhuar 5 pedagogë me titullin Prof. Asoc. Dr.; 9 me gradën shkencore Dr.			
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Konstatohet se përgjithësisht fusha akademike- kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit. Megjithatë ka disa përjashtime. Kështu nga shqyrtimi i CV-ve vitin akademik 2019-2020 janë dy anëtarë B.H me specialitet në Punë Sociale, E.M me një cikël studimi në psikologji dhe dy të tjerë në punë sociale dhe M.L pa specializim në disiplinën që lektron, por me fokus në edukim. Rekomandohet një vlerësim i kujdesshëm në këtë drejtim.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ iu komunikua se zhvillimi i praktikave mbeten një sfidë edhe për këtë program studimi, megjithatë institucioni bën përpjekje për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme që mundësojnë realizimin e tyre. Ashtu sikurse na u komunikua nga Zyra e Karrierës, kjo e fundit mbështet departamentet në përpjekjet e tyre për të lidhur këto marrëveshje. Departamenti kujdeset që të përzgjedh ekspertët sipas fushës së profileve për të referuar në auditor në kuadër të praktikave profesionale. Ndërsa për ndjekjen e këtyre praktikave përcaktohet një pedagog i departamenti, i cili ka edhe statusin e këshilluesit të karrierës.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Ky program studimi nuk parashikon orë laboratorike në kurrikul.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi II.6**

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbytjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ iu komunikua se në procesin e përmirësimit të përmbytjes së programit të studimit, departamenti konsultohet me bashkëpunëtorë dhe partnerë të tregut të punës (referuar kryesisht Bordit të Tregut të Punës). Gjithashtu, gjatë takimeve u konfirmua se edhe ndarja e këtij programit në pesë profile ka ardhur si rezultat i input-it që kanë dhënë këta të fundit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë takimit me drejtuesin e departamentit, GVJ iu konfirmua se departamenti organizon mbledhje periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për programin dhe për të ndërhyrë, po ashtu edhe studentët konfirmuan se konsultohen me personelin akademik dhe drejtuesin e departamentit. Kështu, një tjetër burim që kanë kontribuar në hapjen e profileve të reja në këtë program kanë qenë vetë studentët.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Në takimin me përgjegjësen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit të Studentëve, GVJ iu konfirmua se institucioni i jep një vëmendje të veçantë ALUMNI. Kjo zyrë mban kontakte me studentët ALUMNI, merr informacion mbi karrierën e tyre, i fton ata në takime dhe konsultohet me ta, atë në masën më të madhe janë anëtarë të Bordit të Tregut të Punës.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Në takimin me drejtueset e njësisë kryesore/bazë, GVJ iu konfirmua se kanë marrëdhënie bashkëpunimi institucione të ndryshme që konsultohen për të bërë ndryshime/përmirësime të programeve të studimit. Në këtë program studimi u përmend marrëdhënia e bashkëpunimit me Urdhrin e Psikologut, ku kanë diskutuar për përshtatshmërinë e profileve të këtij programi dhe kuadrin ligjor të tij			
<b>Shkalla e përmbytjes së standardit</b>	Nuk përmbytet	Përmbytet pjesërisht	Përmbytet kryesisht	Përmbytet plotësisht
				X

Shkalla e përmbytjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbytet	Përmbytet pjesërisht	Përmbytet kryesisht	Përmbytet plotësisht
			X	




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion si dhe nga takimet me përgjegjës të departamentit, stafin mësimdhënës në këtë program studimi, mësohet se institucioni përgjithësisht ka në funksion të përmirësimit të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve sistemin UET LMS, i cili i mundëson stafit akademik dhe studentëve të shkëmbejnë material dhe informacione në funksion të procesit mësimor (Ref. 46, 46.1, 46.2, 46.3).</p> <p>Përgjithësisht, institucioni mësohet se vazhdimisht ka realizuar trajnime për stafin për rifreskimin e njohurive për përdorimin e sistemit LMS, gjithashtu vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit, formati për monitorimin e silabuseve, dokumenti mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, të gjitha këto janë struktura që synojnë trajnimin dhe monitorimin në përmirësimin e metodave inovative në mësimdhënie.</p> <p>Pra, ky është një proces në vijimësi për të mbajtur në përditësim stafin dhe ecurinë e tij në cilësi (Ref. Minutat e takimit, 36, 37, Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademi.</p>	<p>Për sa i përket strukturave përgjegjëse mbi monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies mësohet se për personelin akademik njësi bazë ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili punën e tij e bazon në tre dokumente që janë: Plani i veprimit KSBC- 2018-2019; Manuali për sigurimin e brendshëm të Cilësisë dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Përmes tyre monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor në UET. Kjo ndodh edhe për programet e tjera të studimit.</p> <p>Këtë të dhënë e përftuam edhe nga takimi me stafin akademik me kohë të plotë, të pjesshme, grupi i RVB, përgjegjësi i departamentit si dhe nga ZSBC.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët e këtij masterit profesional në takimin me ta pohuan se përfshihen në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve prej tyre (Ref. G-III-4-2), gjë që realizohet në fund të çdo semestri. Në këtë mënyrë, studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët mësimdhënës, por edhe për stafin ndihmës në këtë program studimi. Pyetëtori është anonim gjatë dhënies së vlerësimit.</p> <p>Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik</p>





	<p>të pedagogëve. Edhe pse fokus grupet ishin një formë e re e vjeljes së të vlerësimeve për mësimdhënien.</p> <p>Gjithashtu, studentët kanë në dispozicion formularin (Ref. 40.1) për ankesat, përmes të cilit mund të adresojnë shqetësime të çdo natyre në strukturat përgjegjëse.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Politika e institucionit është e tillë që të realizojë vlerësime periodike të ndërmarra institucionalisht dhe ato pas zbardhjes së rezultateve i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore (rektoratit, dekanit dhe departamentit). Stafii akademik njihet me të dhënat e këtyre vlerësimeve mbi performancën individuale si individualisht ashtu edhe në faqen e institucionit.</p> <p>Këto të dhëna u morën jo vetëm nga takimi me përgjegjësin e departamentit si dhe stafin akademik por edhe nga ZSBC.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Përsa i përket mekanizmave që institucioni përdor për të promovuar e inkurajuar personelin akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie njëri prej këtyre mekanizmave është rishikimi e ripërditësimi i silabusit përkatës me literaturë të 5 viteve të fundit, me përbushje të kriterëve të legjislacionit në fuqi, etj. Mekanizma të tjerë janë edhe mobiliteti jashtë vendit nëpërmjet projekteve Erasmus +, apo përfshirja në projekte kërkimore, aplikimi dhe fitimi i grante shpërblyese për pedagogët që publikojnë në revista me faktor impakti, etj. Kjo pohohet edhe nga përgjegjësi i departamentit, por edhe nga stafi akademik në këtë program studimi. Vlerësohen të jenë forma të mira të promovimit e avancimit në karrierë profesionale të stafit mësimdhënës.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Standardi III.2**

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga bisedat me stafin akademik të brendshëm e të jashtëm, takimet me studentët e këtij programi, si dhe dokumentet e dërguara, takimin me grupin e RVB u mësua se mësimdhënia bazohet kryesisht në leksione dhe seminare, kjo e mbështetur në formën ndërvepruese të zhvillimit të njohurive (Ref.7), roleplay, raste studimore, etj. Këtyre formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, punimet e diplomës, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare.</p> <p>Nga ana tjetër, institucioni ka përdorur edhe veprimtari të tjera ndihmëse si leksione e hapura (Ref. 51). Takim me presidenten e urdhrat të psikologut) me të ftuar të profilit të këtij programi studimi, konferenca shkencore (Ref. 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200. Ditët e studimeve Shqiptare 2019, 2018, 2017, 2016, 2015,</p>



	2014), etj.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Nga takimet me studentët e këtij program studimi dhe stafit akademik të përfshirë në të mësohet se personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit. Por mund të theksohet edhe liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si video projektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Nga dokumentet e vëna në dispozicion mësohet se institucioni ka ndërtuar një protokoll (Ref 45.2) që i shërben pedagogut për përmirësimin e literaturës për lëndën që mbulon. Por do të sugjerohej që të shtoheshin literatura profesionale në formatin hard copy për të përshtatur edhe më tej tekstet mësimore në fushën e studimit. Gjithsesi, përgjithësisht mund të thuhet se institucioni ka iniciativë të mirë për praktika pozitive për sa i përket lehtësimit të mobilitetit të stafit në mësimdhënie jashtë vendit (Ref. 5) duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kompetencave profesionale nga ky shkëmbim në mësimdhënie në universitetet e huaja.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Përgjithësisht mund të thuhet se për sa i përket metodologjisë në mësimdhënie duke iu referuar cilësisë së silabuseve, apo metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme stafit akademik i krijohen kushte për një mësimdhënie efektive, kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik efektiv dhe ke kontratë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vetë ZSBC i kërkon departamentit të përditësuesj literaturën dhe kjo faktikisht ndodh. Ndërsa për sa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces të rritjes së përfshirjes së mendimeve të tyre në procesin e mësimdhënies nuk ka ndonjë evidencë në dokumentacionin që kemi në dispozicion dhe as ndonjë informacion gjatë takimeve me stafin akademik apo edhe studentët.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Nga vlerësimi i mënyrës sesi janë hartuar silabuset ka larmishmëri për sa i përket formave të përdorura në mësimdhënie, duke e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimin. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri mbi fushën. Nga ana tjetër, pritet të vlerësohet edhe puna e stafit të ri akademik të ardhur së fundmi në departament.
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të	Bazuar në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student, mund të theksohet se respektohet dinjteti dhe integriteti i çdo studentit. Procesi i mësimdhënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e



ndërsjellë mes tyre.	mendimit respektohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi III.3**

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita ë institucion vihet re dhe mësohet se ai ka vënë në dispozicion infrastrukturën fizike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në tre godina, në një sipërfaqe prej 11.500m <sup>2</sup> , salla leksion 10, me kapaciteti rreth 1515 vende. Sallat e seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë gjithsej 14 me 35 vende secila. Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i agjencisë së kontraktuar për këtë shërbim.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Ambientet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimorë, si video projektor, etj. kushte të përshtatshme mësimdhënieje.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratorë informatike, bibliotekën online në Sage dhe Ebsco. Sistemi moodle (UET LMS) bën të mundur që studentit të përditësohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Ambientet përgjithësisht janë të mbuluara me sinjal Wifi në mënyrë që studentët të hyjnë lirisht faqen e internetit.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga vizita në bibliotekën e fakultetit vihet re se literatura bazë në gjuhën shqipe duket e kufizuar në tituj dhe cilësi të botimit (Ref. 42). Literatura e përkthyer në shqip dhe e përdorur për nevojat e zhvillimit të lëndëve mësimore është botimi i viteve më parë. Për sa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online EBSCO & SAGE. Por duke qenë një master i ri me profile, edhe literature specifike nevojitet të jetë e përditësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe e vështirë të sigurohet gjithnjë. Ndaj do të sugjerohej plotësimi, shtimi i kësaj literature në vijimësi në përputhje edhe me profilet e këtij masteri.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Përsa i përket botimeve në dispozicion të drejtimeve kryesore të programit të studimit sipas të dhënave të bibliotekës dhe informacionit të shpërndarë nëpër dokumentet kemi një listë prej 207 tekstesh në fushën e psikologjisë, prej të cilave pjesa më e madhe e tyre kanë një vit botimi para 2010, ndërsa ato pak tekste dhe artikuj të viteve të fundit janë punime doktorature dhe artikuj shkencorë. Një pjesë e vogël e teksteve janë në gjuhë të huaj



	<p>kryesisht botime të viteve 2001-2010.</p> <p>Megjithatë, pranë bibliotekës kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët, por këtij aspekti i shërben edhe biblioteka online EBSCO &amp; Sage.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të aksesimit në bibliotekën online të EBSCO dhe Sage, gjithashtu mund të thuhet se fondi i bibliotekës së institucionit kishte tekste në formë elektronike të fushës së psikologjisë në gjuhë të huaj që viheshin në dispozicion të stafit dhe studentëve të programit të studimit. Nuk u pa ndonjë abonim në revista të fushës së psikologjisë në bibliotekë. Biblioteka e UET ishte pjesë e sistemit COBISS Net (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), ku janë të përfshira vendet e rajonit të Europës Juglindore.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura mbështetje të zhvillimit të detyrave të ndryshme nga student ishte e përshtatshme dhe të lejonte akses në një sërë formash ndërveprimi, si mbulimi i ambienteve të UET-it me Wi-Fi, biblioteka e pajisur me sallë leximi dhe hapësira komode për të punuar me literaturën, kompjuter në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë literaturën on-line të vëna në dispozicion përmes shfrytëzimit të platformave online Cobiss, Ebsco, Sage.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ka një sistem të tijin teknologjik që e përdor për procesin mësimor, duke lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin e studentit me stafin akademik dhe studentët e tjera. MOODLE (UET LMS), është një sistem që i mundëson studentit në kohë reale të përditësohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Përmes këtij sistemi studenti mund të komunikojë në forume të hapura me pedagogët e kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët on-line.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Përsa i përket përdorimit të hapësirës vetjake dedikuar stafit dhe studentëve mund t'i referohemi sistemit LMS, ku secili prej përdoruesve regjistrohet dhe në vijim akseson në sistem në çdo kohë dhe vend duke u informuar në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme, etj. Ky sistem i brendshëm komunikimi shihet si tepër efektiv në drejtim të rritjes së aksesit në burimet e brendshme të informacionit si nga ana e stafit dhe e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni në lidhje me orientimin, asistimin dhe mbështetjen nga ana e personelit akademik për studentët gjatë fazës së diplomimit (Ref. B II), UET ka një strukturë të mirë organizuar, e cila i krijon kushtet e nevojshme studentit në përmbylljen me sukses të kësaj faze. Kjo realizohet konkretisht nga Departamenti, i cili paraqet studentëve listën e pedagogëve që janë në dispozicion për programin e studimit, më pas studenti plotëson formularin e aplikimit për temën e diplomës, departamenti bën miratimin e tyre sipas kritereve</p>



	specifike, gjithashtu, në vijim janë të detyrueshme për studentin seancat metodologjike me udhëheqësin e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Mund të thuhet se institucioni ka struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie. Përmes Zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit (Ref. E- VII), Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Ref. 30.2), Koordinatorit të programit të studimit (Ref. Minutat e takimit, 36), Zyrës së kurrikulës (Ref. E-VIII). Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standardet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Vërtetohet se roli i departamentit në drejtim të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie shfaqet përmbushësh nevojash në drejtim të përzgjedhjes e angazhimit të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>Përsa i përket këtij kriteri konstatohen disa paqartësi që lidhen me kualifikimin e stafit të angazhuar në këtë program studimi, mungesë e cikleve të studimit brenda fushës së psikologjisë. Ka lëvizje të stafit akademik gjithashtu këtë vitin e fundit, disa pedagogë të larguar dhe disa të tjerë të ardhur. Larguar një profesor i asociuar dhe dy doktorë nga ky master dhe ardhur dy doktorë të tjera. Lëvizjet e stafit janë kryesisht humbje për departamentin dhe programin gjithashtu.</p> <p>Konstatimet tona lidhur me stafin e angazhuar këtë vit akademik mbështetur në të dhënat që na janë vënë në dispozicion mbi kualifikimin dhe përfshirjen në veprimtari kërkimore shkencore, sugjerojnë një nxitje të përfshirjes më të madhe të stafit në drejtim të avancimit në kërkim shkencor përmes publikimit të artikujve shkencorë në revista prestigjioze të fushës së psikologjisë dhe pjesëmarrjes në konferenca apo veprimtari të tjera krijuese, në mënyrë që të rriten aftësitë profesionale edhe në drejtim të mësimdhënies. Nga ana tjetër, mund të thuhet se stafi akademik në këtë program studimi ka edhe problematika që lidhen me vijimësinë akademike të tij në fushën e psikologjisë si p.sh. mund të përmendim B.H, M.L, apo E.M.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja</p>	<p>Mund të thuhet nga takimet me stafin akademik, studentët dhe përgjegjësin e departamentit dukshëm strukturat dhe njësia bazë inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes</p>



inovative të mësimdhënies.	hapësirave në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj. Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën Polis, shfrytëzimit të bibliotekës online.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Përgjithësisht përfshirja e stafit akademik përmes Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve përmes fondeve dhe granteve ndërkombëtare të Komisionit Europian (Ref. 43.4), Erasmus +, etj. nxisin dhe përmirësojnë aftësitë në vazhdimësi në drejtim të avancimit në kërkimin shkencor, duke ndikuar kështu edhe në rritjen e kompetencave në fushën e tyre të ekspertizës dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Por mund të themi edhe se vënia në dispozicion të stafit akademik të një fondi kërkimor, tek i cili kërkuesit mund të aplikojnë për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërblim pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar, mbështet këtë proces. Stafit në këtë mënyrë është i motivuar të realizojë kërkim shkencor të vlefshëm dhe nxitës.
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Nga takimet me stafin akademik dhe me përgjegjësin e departamentit mësohet se në lidhje me trajnimet e personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja mund të përmendim trajnimin për përdorimin e Sistemit LMS, referuar edhe Strategjisë së Kërkimit Shkencorë në UET 2017-2020, Qendra e Metodologjisë dhe Kërkimit mund të ofrojë trajnime 1-ditore ose me gjatë (profesional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet kryesisht janë të ndarë në katër grupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike. Por nuk kemi evidence të qarta për mënyrën sesi implementohet kjo strategji realisht.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Nevojitet të theksojmë se personeli i angazhuar në këtë program studimi kërkon të përmirësohet vazhdimisht, kjo lidhur me kualifikimin dhe fushën e ekspertizës që zotërojnë dhe përputhjes me lëndët apo modulet që mbulojnë (Ref. 30.8), duke e vënë theksin jo vetëm te vijimësia në tre cikle studimi brenda fushës, por edhe në kualifikime të tjera profesionale duhet të përkohet me lëndën që ata mbulojnë. Referuar evidencave të vëna në dispozicion ky kriter nevojitet të shihet në vijimësi, kjo pasi një pjesë e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi rezulton pa një linjë të pastër të kualifikimit në fushën e psikologjisë (M.L, B.H, E.M).
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe	Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidence të qarta përse i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga





raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori/kolegu (Ref. 30.8), dhe formulari i vetëvlerësimit të performancës, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Vërtetohet se institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie. Përmes Zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Koordinatorit të programit të studimit, Zyrës së kurrikulës (Puna e këtyre strukturave synon gjithnjë dhe në vijimësi monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standardet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

**Standardi III.5**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Vërtetohet se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit (Rregullore mësimore e programit MP Psikologji e aplikuar) të studimit, sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar, urdhrin për vlerësimin e studentëve me aftësi shikimi të kufizuar, mbi punimin e diplomës së masterit. Mësohet se një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin LMS.			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Edhe në rregulloren e institucionit vlerësohet se kjo procedurë është e përcaktuar dhe se respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion gjendet lehtësisht nga studenti në çdo kohë në sistemin LMS.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Studentët vërtetojnë se iu jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të dhëna në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>



standardit				X
------------	--	--	--	---

**Standardi III.6**  
**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Bazuar në procedurën e titulluar “Sistemi i vlerësimit të Studentëve”, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Elementë kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar (Formati i tezës së provimit përfundimtar), Riprovimi, Përmirësimi, Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar për programin e studimit. Nuk kemi evidencë për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik, por ekziston një strukturë e mirë organizuar përmes sistemit LMS për paraqitjen e vlerësimit të studentëve në të gjitha aspektet e përmendura më sipër.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Njësia bazë ka një procedurë të mirë organizuar në drejtim të hapave e procedurave që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit (Sistemi i vlerësimit të studentëve) nga pedagogu i lëndës. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit për t'u miratuar nga Përgjegjësi i Grupit mësimor përkatës, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik. Praktikat profesionale, provimi i përgjithshëm përfundimtar, dhe mbrojtja e diplomave realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e koordinatorës së departamentit (Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore) që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga Drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatin e çdo studenti. Ç sekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në</p>



	Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në lidhje me komentet apo feedback-un mbi rezultatet e testimit nuk kemi evidenca për të gjykuar plotësisht mbi këtë aspekt, por ka procedura të mirëorganizuar për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar që t'u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxëniet. Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezen origjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga staffi akademik synojnë që përmes rregullave që lidhen me kushtet si mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mirat për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli. Por sugjerohet që institucioni të ketë një sistem verifikimi të evidentimit të plagjiaturës për të kontrolluar çdo problematikë të mundshme në detyrat e kursit, diploma në nivelin master apo studime të ndryshme të studentëve.			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Verifikohet se institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë përsa i përket gjithë procesi që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse, sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjithashtu, verifikohet se institucioni respekton procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit.			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Duke u bazuar te rregullorja e UET, por edhe te rregullorja e programit dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit të MP “Psikologji e Aplikuar” me profile, i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë profilesh në kontekstin e shkencave shoqërore, por nga ana tjetër kjo larmishmëri mund të shihet edhe si pengues në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën dhe në një paaftësi për të zhvilluar kompetenca profesionale te studenti përsa i përket një profili të pastër psikologjik. Vihet re se diferencat në thellimin e profileve për secilin prej tyre nuk i kalojnë 3 lëndët. Kjo sasi lëndësh nuk mundet të përbëjë diferencën për të dalluar njërin profil nga tjetri si dhe për të realizuar në mënyrë cilësore thellimin e studentit në profilin përkatës.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Pohohet se institucioni dhe ky program studimi krijojnë të gjitha kushtet që studenti të zhvillojë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si në aspektin teorik përmes lëndëve që janë pjesë e kurrikulës për këtë program studimi, por edhe praktikisht përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin LMS dhe sistemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Për këtë kriter mund të thuhet se mund t'i referohemi edhe iniciativës së njesisë bazë, e cila realizon në mënyrë periodike analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Gjithashtu, në fundin e çdo viti akademik secili pedagog rishikon syllabusin dhe e përditëson atë me ndryshimet e nevojshme për vitin pasardhës. Për këtë program studimi ky është viti i parë i diplomimit të studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në lidhje me aplikimin e këtij kriteri kemi eksperiencën e vetëm këtij korriku dhe shtatori 2019 dhe vetëm këto evidenca për të nxjerrë konkluzione. Studentët i janë nënshtruar një testi/provimi përfundimtar i cili është përbërë raste studimore dhe ka pasur natyrë praktike në aplikim. Një test i tillë na u vu në dispozicion nga institucioni, por vlerësohet që një mënyrë e tillë konkludimi të studimeve MP “Psikologji e Aplikuar” me profile, të mbetet sërish një mënyrë paksa teorike dhe studentit nuk i jepet mundësia për të punuar një dosje profesionale në fushën e tij të profilit. Një gjë e tillë do ta kthente në më praktikë aftësinë e tij në profilin përkatës.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Sa i përket këtij kriteri, mund të themi se institucioni ka praktika të mira lidhur me hapësirat që kanë studentët për të përfituar nga evente të ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Patjetër që këto nuk organizohen në nivel programi, por në nivel institucional.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë	Ky kriter është i rëndësishëm për të siguruar edhe rëndësinë e cilësisë së mësimdhënies në MP. Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e



<p>njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka pak evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve karakterizuese sugjerohet të kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë. Gjithsesi, vlerësohet që kjo gjë të kapërcehet nëse stafi akademik është i pandryshueshëm. Si dhe praktika profesionale të jetë ekskluzivisht e lidhur me fushën e profilizimit të zgjedhur nga student. Sërish i mbetemi mendimit se studenti nuk mund të profilizohet në fushë me anë të vetëm 2-3 lëndëve të lidhura me një profil të caktuar. Profile duhet të thellohet në një sasi më të konsiderueshme lëndësh.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Vërtetohet se departamenti bën një punë të mirë për të zgjidhur problematikat e lidhura me mësimdhënien dhe ky kriter bazuar në mënyrën e ndërtimit të silabuseve të lëndëve/moduleve aplikohet edhe bazuar në takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, që duket se përmbushet (dokumenti mbi parimet e hartimit të syllabuseve).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Vlen të theksohet se ky kriter duhet parë në vijimësi, pasi personeli akademik sa e kanë filluar lektimin e lëndëve dhe duhet vlerësuar edhe mënyra sesi do implementojë në planin mësimor të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë. Duhet të kihet parasysh nga stafi akademik që idetë inovative t'i ketë në fokus të vazhdueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Vërtetohet se vullneti i mirë vënë re dukshëm bazuar në përfshirjen në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca qëndron në bazë të departamentit, por nuk kemi asnjë evidencë që të na tregojë përfshirjen e studentëve të këtij programi studimi. Argumenti i institucionit në lidhje me këtë kufizim që u bëhet studentëve të këtij programi studimi lidhet me faktin e mungesës së përvojës dhe mungesë në njohuri të thelluara profesionale në fushën e kërkimit shkencor. Për vitin 2018-2019, nuk rezultojnë të kemi raste të studentëve të programit, që të jenë përfshirë në veprimtari të tilla.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera kemi nismën me Urdhrin e Psikologut, mbi kriteret dhe kushtet e licencimit të psikologëve, dhe mobiliteti i stafit dhe studentëve të këtij programi shihet si pozitiv, por është herët për të vlerësuar vijimësinë e tij pas riorganizimit. Shumë studentë pasi kanë përfunduar studimet në këtë master, priren t'i transferojnë ato në MSh po me profile. Sipas tyre kjo nevojë lidhet me dëshirën e tyre dhe nevojën për thellim të domosdoshëm pasi kjo është e dukshme. Por nga ana tjetër vlen të theksohet se mobiliteti i studentëve (edhe pse është një vit akademik si shtrirje e programit të studimit) nuk është i mundur edhe për shkak se MP me profilizime të tilla nuk ka në sistemin as publik dhe as jo publik të arsimit në vendin tonë. Kjo</p>



	penalizon disi studentët që duan të lëvizin në semestra në institucione të tjera të arsimit të lartë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi III.8**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Vlen të theksohet se bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit MP “Psikologji e Aplikuar” me profile, dhe mbi dokumentet: Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit si dhe Formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar, institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët japin provimin final, ose mbrojnë diplomën (Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit). Kriteret për mbrojtje diplomës për programim MP “Psikologji e Aplikuar” me profile janë provimi me shkrim. Njësia bazë ka një format të posaçëm për provimi të përgjithshëm përfundimtar (PPP) të dokumentet teza provimi final.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Përsa i përket realizimit të provimit final për studentët që përfundojnë këtë program studimi mund të themi se është një formë jo shumë e përshtatshme për të përmbyllur studimet master profesional. Edhe pse teza e provimit përfundimtar është e vlefshme dhe e përshtatur me profilin e tyre të përzgjedhjes si dhe përmban një situatë problemore ku student duhet të paraqesë të gjitha aftësitë dhe kompetencat e tij për ta zgjidhur atë, kjo formë mbetet një formë teorike e përmbylljes së studimeve të këtij niveli. Do të sugjerohej një formë më praktike e një rasti konkret që vetë student ta ketë përzgjedhur në terren në një kontekst që i përshtatet profilit të tij të zgjedhur.
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar, takimet me studentët dhe stafin akademik mësohet se praktika profesionale ka 6 kredite. Në përfundim të zhvillimit të praktikës profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës ka për detyrë të dorëzojë pranë Koordinatorës së Departamentit formularin e vlerësimit të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në institucion/organizatë/kompani, formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studenti dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni. Edhe pse qendrat e praktikës shpesh gjehen edhe vetë nga studentët, rekomandohet që institucioni të realizojë edhe më marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera për të realizuar një praktikë sa më profesionale të mundshme në ndihmë të studentit.
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk përmbushet</b> <b>Përmbushet pjesërisht</b> <b>Përmbushet kryesisht</b> <b>Përmbushet plotësisht</b>



standardit			X	
------------	--	--	---	--

**Standardi III.9**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Vërtetohet se institucioni e harton provimin final me anë të një teze të hartuar sipas profilizimit përkatës. Kjo tezë paraqet një situatë problemore dhe i jepet studentit të mendojë për zgjidhjen e saj.  Do të sugjerohej që përmbyllja e studimeve të këtij MP të realizohej me anë të një dosjeje profesionale me qëllimin që student të zgjidhte përmes aftësive të tij të fituara situatë konkrete dhe jo hipotetike.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Vërtetohet se studenti e ka mbështetjen e nevojshme për të marrë udhëzimet e duhura për provimin përfundimtar përmes përgjegjësit të departamentit, pedagogëve të lëndëve dhe koordinatorit të programit si dhe koordinatorit për studentët për të marrë udhëzimet e nevojshme për provimin. Kjo na u vu në dispozicion nga burimet e studentëve, stafit akademik dhe takimit me koordinatoren e programit e të studentëve.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Konfirmohet se hartimi i tezës së provimit final në këtë program studimi bazohet në të gjitha dokumentet e rregullores së programit të studimit MP “Psikologji e Aplikuar” me profile, dokumentit të hartimit të tezës së provimit, takimin me stafin akademik në program si dhe me studentët e programit. Sekretaria mësimore na vuri në dispozicion një tezë provimi për profilet klinike, shkollore dhe organizacionale.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Sipas studentëve të programit në takimin me ta u diskutua edhe pika e orientimit dhe ndihmës të studentëve për pikën e diplomave. Por duke qenë se ky master përmbyll studimet me provim përfundimtar, tezat e diplomës janë të pazhvilluara.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët kanë mbështetje prej pedagogëve apo stafit akademik. Por për komentin e bërë në kriterin paraardhës i mbetemi po të njëjtit mendim.  Sugjerohet që provimi përfundimtar i këtij programi të realizohej me anë të një dosjeje më praktike të studentit ku ai të sprovohej më konkretisht për sfidat e një situatë konkrete sipas profilit të tij.
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Politikisht dhe teorikisht kjo ndodh. Studentët kanë gjithë mbështetjen e nevojshme për të realizuar një temë diplome po të ishte e mundur dhe stafi do të angazhohej në këtë sfidë.  Për këtë rast provimi përfundimtar ata marrin mbështetjen e nevojshme gjithashtu nga departamenti si dhe nga koordinatori i studentëve.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Konfirmohet se teza e provimit përfundimtar me pyetjet përkatëse dhe me pikët për secilën pyetje, përkthehet në nota dhe studentit vlerësohet me notë e cila është në bazë të një kriteri përkthimi të



	paraqitur edhe në rregulloren e programit dhe që studenti e njeh paraprakisht.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Për aq kohë sa MP është një produkt i ri i programeve të studimit të UET që është aplikuar prej shtatorit të vitit 2018, është hartuar dhe një suplement i diplomës së studentëve megjithatë ai nuk përmban specifikimet sipas profileve përkatëse. Sugjerohet që të përmirësohet përmbajtja e suplementit ku të specifikohen profilet përkatëse të këtij programi studimi.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Konfirmojmë që në përfundimin e studimeve studentëve iu vihet në dispozicion gjithë plan programi i studimit të zhvilluar. Studenti gjithashtu pajiset nga institucioni brenda 6 (gjashtë) muajsh me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UET, me suplementin e diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, UET-i lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave. Nuk na u vu në dispozicion ndonjë kopje e diplomës përkatëse për arsyen e diplomimeve të vona dhe kohës së pa përmbushur për të marrë këto nga studentët e diplomuar në muajt korrik e shtator 2019.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Sipas RVB mund të themi se pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Por ky është një proces në vijimësi për shkak të jetëgjatësisë së sapofilluar të programit MP. Nga ana tjetër mund të themi se institucioni disponon një data bazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al  
Web site: www.ascal.al



**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjitha dosjet e personelit akademik si atij efektiv dhe atij me kontratë që janë të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji e Aplikuar” me profile, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor - shkencor dhe administrativ. Kjo zyrë është përgjegjëse për ruajtjen dhe përditësimin e Dosjeve Individuale të personelit akademik. Gjatë takimit me përgjegjësen e kësaj zyre, GVJ shqyrtoi dosjet e dy anëtarëve të personelit akademik dhe konstatoi prezencën e të gjithë elementëve të përcaktuara në dokumentin e Rregullores së Burimeve Njerëzore.</p>								
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatorë të institucionit.</p>	<p>Sipas të dhënave të siguruar nga DVV, takimeve me GVB, personelin akademik dhe përgjegjësen e zyrës së burimeve njerëzore rezulton se institucioni ndjek procedura transparente dhe ligjore për të rekrutuar personelin akademik. Procedurat janë qartësisht të shprehura në dokumentin e Rregullores së Burimeve Njerëzore.</p>								
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatorë dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni ka procedura të përcaktuar për kriteret e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.</p>								
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në DVV, dokumentacionin mbështetës si dhe në takimet me GVB, personelin akademik dhe përgjegjësen e ZBNj rezulton se IAL ka përcaktuar procedura për rekrutimin e personelit akademik dhe ka një përputhje të personelit të rekrutuar me programin e studimit, me përjashtim të tre rasteve: personeli akademik efektiv B.H, e cila nuk ka edukim të vazhduar në psikologji, por disponon formim akademik dhe eksperiencë në një disiplinë tjetër (punë sociale), personeli akademik efektiv E.M, e cila është e angazhuar në mësimdhënien e një moduli specifik të këtij programi (Bazat e Psikoterapisë) ka formim Bachelor në psikologji dhe në ciklin e dytë dhe të tretë e ka realizuar në punë sociale ose rasti i personelit PAK M.L. e cila nuk ka formim në psikologji dhe kualifikimin e duhur për të dhënë një modul specifik në psikologjinë e këshillimit (Teori kognitiv bihejviorale).</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="574 1630 734 1697">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="734 1630 941 1697">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="941 1630 1149 1697">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1149 1630 1345 1697">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficientë dhe efektive**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Vërehet se institucioni disponon kapacitetet e nevojshme infrastrukturore për të mundësuar që personeli të kryej në komoditet detyrat e caktuara. Institucioni ka parashikuar salla për departamentet, zyrat dyshe, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme si: kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi. Pavarësisht se këto janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm, duhet parë mundësia e shtimit të stafit për disa struktura, të cilat kanë një peshë të madhe pune, sidomos pas riorganizimit dhe hapjes së profileve të reja të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtijshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni tregon përpjekje në drejtim të mundësive të ofruar që stafi akademik të inkurajohet për kualifikim të vazhdueshëm, mundësi të tilla si: zhvillimi i konferencave shkencore vjetore (DSSH), fondi prej 75'000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara, përfshirja në PMK, si dhe mundësia për mobilitet akademik përmes programit ERASMUS +. Konstatohet një përfshirje e ulët e personelit akademik të këtij programi në mundësitë (përmendur më sipër) për kualifikime të mëtijshme të ofruara nga institucioni.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtijshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Sikurse shprehet edhe në RVB dhe po ashtu në takimin me zv/ rektoren e kërkimit shkencor vërehet se institucioni përmes Qendrës së Metodologjisë dhe Kërkimit ka ofruar trajnime për stafin akademik sesi të bëjnë punë kërkimore të cilat përmbushin kriteret për publikime në revista me faktor impakti. Përveç këtij trajnimi nuk konstatohen trajnime të tjera për zhvillimin profesional të stafit akademik.</p> <p>Ndërkohë që në drejtim të digjitalizimit të procesit të mësimdhënies, institucioni ka krijuar sistemin LMS që mundëson studentët dhe pedagogët të komunikojnë dhe shkëmbejnë informacione.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstaton se burimet njerëzore të angazhuara në këtë program studimi janë optimale për të përmbushur objektivat e tij, me gjithë këtë ngelet për t'u përmirësuar shpërndarja e lëndëve në bazë të profilit të personelit akademik të angazhuar dhe specifikës së modulit që jepet prej tij. Është e rëndësishme që të kemi një ndarje në përgjegjësi dhe detyra sipas ndarjes staf akademik dhe staf ndihmës administrative, pasi në disa raste i njëjti person mbulon njëherësh edhe punën administrative edhe atë akademike si staf i angazhuar në mësimdhënie. Ky konstatim bazohet në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, pedagogët dhe stafin administrative të zyrës së burimeve njerëzore, kurrikulës dhe cilësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p><b>X</b></p>				

**Standardi IV.3**



**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike për këtë program studimi.			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësim nxënies.	Gjatë vizitës në institucion, u vizituan ambientet ku zhvillohej mësimi për studentët e këtij programi dhe konstatohet se mjediset mësimore janë të përshtatshme për të zhvilluar mësim. Ambientet rezultonin të kishin infrastrukturën e nevojshme teknologjike për të realizuar procesin mësimor si p.sh., PC, projektorë, foni dhe WI-FI.			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për realizimin e procesit mësimor në këtë program studimi nuk nevojiten laboratorë apo aparatura të veçanta. Vërehet se sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësim.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Vërehet se institucioni ka laboratorë të cilët mund të përdoren edhe për këtë program studimi, në kuadër të përdorimit të programeve kompjuterike në përpunimin e të dhënave për lëndë të kërkimit shkencor.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Vërehet se institucioni ka kapacitetet e nevojshme për të mundësuar zhvillimin e praktikave dhe veprimtarive të tjera. Kështu, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës mundësohet lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe organizata të ndryshme, në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Por këto marrëveshje bashkëpunimi mbeten të cunguara dhe nuk ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë profilet e këtij programi studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të**



procesit të mësimxënies për studentët e programit të studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion konstatohet se institucioni vë në dispozicion për studentët bibliotekën, e cila qëndron hapur nga e hëna në të shtunë në oraret 09.00 - 20.00 dhe në periudhën e sezonit ky orar është edhe më gjatë.			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi listën e kopjeve fizike të librave në fushën e psikologjisë, e vila iu vë në dispozicion dhe rezultoi se janë 207 tituj të renditur, por nga një shqyrtim i titujve shihen edhe libra që nuk i përkasin kësaj fushe apo nuk janë libra që mund të përdoren në kontekstin akademik (p.sh., “Përse të tjerë duam dhe me të tjerë marthohemi”, “Dieta?! Jo vetëm”), ndërsa fondi i librave fizik në programin e studimit shihet të jetë i kufizuar. Sugjerohet një përzgjedhje më e kujdesshme e titujve të librave të përshtatshëm për kontekstin akademik dhe po ashtu të lidhur me këtë, e balancuar për të pestë profilet që ofrohen në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV si dhe në takimet gjatë vizitës në institucion u konfirmua se institucioni ka siguruar akses për studentët që ndjekin këtë program studimi në bibliotekat online si Sage, Ebasco dhe Questia kundrejt asnjë detyrimi financiar.			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Në takimin me përgjegjësen e bibliotekës së institucionit, GVJ iu komunikua se në kompjuterët që ndodhen në bibliotekë, studentët kanë mundësi të aksesojnë bibliotekat online. Premtuese për veprimtarinë akademike dhe kërkimore shihet edhe fakti që biblioteka e institucionit është pjesë e sistemit COBISS.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga shqyrtimi i DVV, konstatohet se institucioni bën përpjekje të pasurojë bibliotekën dhe ka vendosur një procedurë sesi të bëhet pasurimi i saj ( <i>referenca e formularit për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë</i> ). Por pavarësisht kësaj, kërkesës tonë për të parë një procedurë për marrjen e teksteve të reja për këtë vit akademik nuk i vu në dispozicion ndonjë informacion apo material as nga biblioteka dhe njësia bazë.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Konstatohet se biblioteka është në dispozicion të studentëve, e përputhur me oraret që zhvillohen veprimtaritë akademike të këtij programi studimi. Biblioteka ka gjithsej 150 vende leximi, 12 kompjuter dhe gjithë ambienti është i mbuluar nga rrjeti Wireless.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë**



**atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të DVV, si dhe në takimet në institucion, vërtetohet se institucioni disponon një sistem të menaxhimit të informacionit në lidhje me studentët, i cili emërtohet UMIS. Në dokumentin “Manuali i përdoruesit të UMIS” shihet se në këtë sistem përfshihen informacione të tilla si informacionin personal të studentit, rezultatet akademike, etj.			
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Konstatohet se sistemi i brendshëm i menaxhimit mundëson ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Në DVV dhe as në RVB nuk duket e qartë nëse në këtë sistem ndodhet informacion dhe dokumentacion për personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Konstatohet se në sistemin e menaxhimit të të mësuarit (LMS) personeli akademik dhe studentët kanë akses të dedikuar në informacionet që lidhen me procesin mësimor që përfshin kursin dhe lëndët që ata ndjekin dhe angazhohen.			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Vërehet se sistemi që disponon institucioni mundëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, literaturën, etj.) mes pedagogut dhe studentëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi LMS është një platformë online që mundëson monitorim për mbarëvajtjen e procesit akademik, si dhe mundëson gjenerim me të dhëna statistikore. Po ashtu, edhe prodhimin e raporteve statistikore për funksionimin e institucionit, si financat, e mundëson dhe sistemi UMIS.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të internetit ( <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a> ) që institucioni disponon, vihet re se programi i studimit është listuar korrekt por nuk ka informacione mbi kurrikulën e këtij programi. Po ashtu jepen informacione për stafin akademik të angazhuar në njësinë bazë (nuk është përditësuar) si dhe prezantohet aktivitetet e ndërmarra nga institucioni. Këto informacione janë të publikuara në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.6**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në RVB dhe në takim me zyrën e financës konstatohet se institucioni harton raporte financiare, të cilat përmbajnë të ardhurat dhe shpenzimet, por dhe përcaktimin e rezervave të nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet për vijimësinë. Theksojmë se këto raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike.			
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Vërehet se nuk ka plan financimi për programet e studimit, ai hartohet në nivel institucioni nga Asambleja ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Asambleja në komunikim me departamentet vendos për caktimin e tarifës së shkollimit. Planifikimi dhe shpenzimet buxhetore bëhen në rang universiteti. Përsa i përket burimeve të të ardhurave pjesa më e madhe vjen nga tarifat e studentëve, por institucioni ka edhe të ardhura dytësore nga projekte, lëshimi i ambienteve me qera, nga vërtetimet e studentëve, donacionet e ndryshme.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Mbështetur në RVB por edhe gjatë takimit me zyrën e financës me përgjegjësen e të cilës GVJ bisedoi rreth burimeve financiare, GVJ shprehet se: Institucioni kryen audit të përvitshëm për situatën financiare. Raporti i auditit përmban pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet; theksojmë se vitet e fundit 2013-2018 është edhe kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj ku institucioni është pjesëmarrës.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Konstatohet se institucioni dokumenton raportet financiare dhe bën planifikimet e nevojshme për të mundur mbarëvajtjen e programeve të studimit në vijimësi.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Në takimin me zyrën e financës, GVJ iu bë e ditur se të dhënat financiare dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Referuar të dhënave institucioni ka asete që justifikojnë mbulimin e shpenzimeve në drejtim të zhvillimit e vazhdimësisë institucionale.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
--	--	--	--	---





## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë.	Konstatohet se institucioni disponon një dokument në të cilin përshkruhen procedurat për pranimi dhe vazhdimin e studimeve <sup>1</sup> deri në diplomim, të cilat rezultojnë të jenë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET), dhe është pjesë e fushatave informuese në shkolla përmes fletëpalosjeve
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Vihet re se institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e transferimit <sup>2</sup> , për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion, konstatohet se kriteret dhe procedurat të pranimit e përzgjedhjes së studentëve <sup>3</sup> për studentët e këtij programi studimi janë përcaktuar qartazi dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, ku përfshihen dokumentacioni i kërkuar, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente, por sugjerohet të përcaktohej tek kriteret për t'u regjistruar në këtë program studimi edhe kriteri i notës mesatare MASR për këtë program studimi dhe që respektohet edhe nga ky institucion i arsimit të lartë. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e UET-it mbi këtë procedurë dhe dokumentet e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Universiteti European i Tiranës, në përputhje me ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM Nr. 295, datë 10.05.2019, ka miratuar kriteret e pranimit për programet e studimit me karakter profesional si dhe programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon	Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe

<sup>1</sup> Dokumenti 36. Të dhënat për cilësinë në hyrje dhe dalje Ba Psikologji.

<sup>2</sup> Dokumenti 39. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.

<sup>3</sup> Dokumenti 37. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.



publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	reklamimin e programeve të studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UET. Format, me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin e Psikologjisë, janë të shumta si Gjimnaz tour, këshillimi në hollin e UET gjatë periudhës së regjistrimeve, etj			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatorë, por edhe takimet informuese (Ref.27.2) që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Ky program studimi ofrohet brenda një viti akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Institucioni konform ligjeve për arsimin e lartë dhe në linjë me rregulloren e tij aplikon kritere e procedura të njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme. Gjithashtu, përmes infrastrukturës në dispozicion krijon hapësirat e nevojshme që studenti të informohet për këtë aspekt.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në fillim të çdo semestri studentët, në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. Këto procedura janë të unifikuara për të gjithë universitetin dhe janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të syllabusit të lëndës, të cilat ju jepen studentëve në fillim të çdo viti akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka dokument i cili mund të përdoret nga studentët për të punuar punimin e diplomës (Ref.10). Dokumenti është i strukturuar dhe i kuptueshëm.
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Sipas RVB dhe gjatë takimeve, konstatohet se UET zhvillon Javën e Orientimit qëllimi është informimi i studentëve të rinj që të njihen me programet, pedagogët, ambientit dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Po ashtu gjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh sipas fakulteteve. Këto bëhen me takime të



	drejtpërdrejtë në mes stafit të UET dhe studentëve të interesuar			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Konstatohet se studentët informohen mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet disa burimeve si: këshillimin me stafin akademik, kontaktit me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit apo kontratës që nënshkruhet me UET në momentin e regjistrimit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Konstatohet se institucioni përmes sistemit online LMS ju vendos në dispozicion studentëve të gjitha dokumentet e nevojshme për studime dhe përfundim të programit. Studentët që nga fillimi i semestrit për çdo lëndë janë të informuar për ngarkesat, temat javore, vlerësimin, literaturën etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Vihet re se institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit dhe secili departament ka këshilluesin e vet të karrierës, që bashkëpunon me këtë zyrë. Institucioni ka borde të tregut të punës që tentojnë të krijojnë një urë lidhëse në mes të tregut dhe universitetit. Nuk është e qartë se sa është përqindja punësimeve përmes këtyre mekanizmave të studentëve të këtij programi. Po ashtu, organizimi i panairëve të punës <sup>4</sup> dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës si pjesë e realizimit të praktikës profesionale në auditor janë veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se institucioni ka në dispozicion një sistem të dedikuar për studentët dhe stafin akademik. Sistemi UET LMS siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, aksesin i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit është lehtësisht i aksesueshëm nga çdo kompjuter, ku log-in realizohet përmes e-mail zyrtarë të institucionit, me të cilin janë të pajisur të gjithë studentët dhe stafi akademik.			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet</b>

<sup>4</sup> Dokumenti 22. Poster panairi i punës 2019.



standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Konstatohet se institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 6 vitet e fundit, konstatojmë se numri i studentëve të diplomuar ka pësuar luhatje përgjatë viteve. Në vitin akademik 2019-2020, gjatë vizitës në institucion u raportua se ishin regjistruar 13 studentë (ndërkohë që regjistrimet nuk kishin mbaruar, kjo shifër mund të ketë ndryshuar). Ndërsa viti 2018-2019 kishte numrin më të lartë të studentëve të regjistruar në këtë program studimi, por nuk jepen të dhënat për numrin e të diplomuarve dhe mesataren në dalje për këtë vit akademik.				
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon të gjitha statistikat vjetore për studentët të regjistruar në sistemin elektronik UMIS. Nga ky sistem mund të gjenerohen statistika të tjera sipas nevojës. Institucioni disponon statistika që lidhen me shkallën e punësimit, kalueshmërinë, transferimet etj				
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni posedon dokumentim fizik dhe atë elektronik për gjithë veprimtarinë e studentëve nga regjistrimi deri diplomim. Të dhënat ruhen në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve. Në takimin me sekretarinë mësimore dhe zyrën e regjistrimit të studentëve na u vu në dispozicion edhe regjistri fizik, dhe u konstatua kjo ecuri.				
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është sistemi kryesor përmes të cilës të dhënat ruhen dhe janë të sigurta. Menaxhimi i sistemit bëhet përmes zyrës së IT. Në dokumentin e manualit (Ref. 46) të përdorimit të këtij sistemi përshkruhet edhe lloji i informacionit që gjenerohet nga ky sistem.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Konstatohet se departamenti përpilon raporte analitike (Ref.38) në të cilin përshkruhen arritjet e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësitimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësim në të ardhmen.				
<b>Shkalla e përbushjes së</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përbushet</td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		



standardit				X
------------	--	--	--	---

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studentëve, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UET-it. Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë IAL-
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Konstatohet se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe procesin akademik. Ato janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit siç është Klubi Freud i Psikologjisë. Po ashtu studentët përfshihen edhe në vlerësimin e stafit akademik përmes sistemit LMS dhe përmes fokus grupeve me drejtuesin e departamentit.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave jo burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	GVJ konstaton se numri i krediteve dhe ngarkesa e studentëve për lëndë të caktuara është në përputhje me shumicën e programeve të tjera te programit master. Po ashtu programi ka një logjikë të caktuar për shpërndarjen e lëndëve përgjatë dy semestrave, ku në secilin semestër student fiton 30 kredite. Semestri i dytë ka një fokus më të mëdha te praktika profesionale dhe përgatitja për diplomën.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	GVJ konstaton se institucioni i ka mekanizmat e duhura ligjore dhe praktike për përfshirjen dhe marrjen e mendimit të studentëve në lidhje me programin aktual që vlerësohet.
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Vërehet se studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm.



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Standardi V.6**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të IAL-ve.	Konstatohet se institucioni ka ngritur Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit, si njësi përgjegjëse për ndjekjen e procedurave, të cilat kanë të bëjnë me informimin dhe shërbimet për studentët. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Po ashtu edhe këshilluesit e karrierës në çdo departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e mbështetjes së studentit për çdo aspekt që ka të bëjë me mësimdhënien dhe orientimin drejt karrierës profesionale.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sikurse u konstatua edhe në kriterin e mësipërm, zyra e kujdesit ndaj studentit dhe këshilluesi i karrierës që çdo departament cakton janë tregues të ngritjes dhe mirëfunksionimit të një sistemi të përshtatshëm të informimit, këshillimit dhe asistencës së vazhdueshme për studentët.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga takimi me përfaqësuesit e zyrës së Karrierës konstatohet se kjo zyrë është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Në UET funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të marrë mendime, ndarë eksperiencën në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës.
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Vërehet se zyra e karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin (Ref 29) e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Referuar këtyre evidencave nga 110 studentë të diplomuar gjatë periudhës 2013-2018 numri studentëve të punësuar në profil është 25, ndërsa një pjesë e vogël janë punësuar jashtë profilit 12, dhe pjesa më e madhe nuk janë mundur të kontaktohen ose janë papunë. Referuar evidencave të kësaj zyre për studentët e diplomuar në vitin akademik 2017-2018, numri total i të diplomuarve është 38



	studentë, nga të cilët 5 janë punësuar në përputhje me diplomën, 4 punojnë jashtë profilit dhe 15 janë të papunë dhe pjesa tjetër 14 janë të padisponueshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se institucioni ka politika të mirë përcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat janë të mbështetura në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, si dhe janë të parashikuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni ka miratuar një grup pune përmes një urdhri administrativ, i cili do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në dy dokumente të rëndësishëm për funksionimin e saj siç janë: Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar një plan veprimi 2018-2019, në të cilin kurrikula harmonizohet me ligjet e reja për arsimin e lartë. Në këtë plan veprimi departamentet kanë rolin kryesor në përcaktimin e përmbajtjes së programeve të studimit, punë e cila do të monitorohet në vijimësi nga zyra e kurrikulës. Aktualisht kjo zyrë mbulohej nga një person. Procesi i riorganizimit paracakton bashkëpunimin me bordin e punës dhe Alumni për gjenerimin e ideve të reja si pjesë e planit të veprimit. Gjithashtu, plani i veprimit si hap tjetër përfshin edhe monitorimin e opinionit të studentëve përmes disa formave si pyetësorët online, fokus grupet etj.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrative me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre trajnimeve do të jenë zyra e burimeve njerëzore, zv. Rektorja për kërkimin shkencorë, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, koordinatoret e departamenteve dhe senati akademik.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë monitoron punën e departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikëqyrëse në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së syllabuseve (Ref. 30.7) me standardet e institucionit për lëndët që zhvilloheshin në semestrin e dytë, viti akademik 2018-2019. Pas këtij procesi u përcjell departamenteve një draft raport nga ku pritet një reflektim. Ky komision ka realizuar një veprimtari mbi mbarëvajtjen e provimeve të ndërmjetme/ përfundimtare (Ref.30.5) edhe në këtë cikël studimi. Këto veprimtari dëshmojnë përkushtimin e institucionit drejt rritjes së cilësisë.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	GVJ konstaton se KSBC ka në fokus të monitorimit dy aspekte, ndërtimin të silabusit të lëndës sipas standardeve të institucionit si dhe vlerësimin e procedurave të ndjekura në drejtim të mbarëvajtjes së provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare. Për aspektin e parë nuk kemi informacion sesi dokumentohet (Ref. 30.7 – është vetëm korrespondencë), ndërsa për aspektin e dytë ka një format mbi raportimin e provimeve (Ref. 30.6)			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Metodologjia më konkrete vlerësuese që përmban raporti vlerësues i brendshëm janë vlerësimet që studentët i bëjnë lëndëve pas përfundimit të semestrit. Mësimdhënësit dhe nevojat e tyre nuk rezultojnë të jenë përfshirë në ndonjë vlerësim sistematik.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	KSBC pas realizimit të procesit monitorues, harton një draft-raport, i cili u përcillet departamenteve për reflektim. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	GVJ nuk mund të gjykoj dot për këtë kriter pasi nuk i janë vënë në dispozicion shembuj të këtyre raporteve dhe nuk është në dijeni të përmbajtjes së tij.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi VI.3**

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë	Konstatohet se KSBC është njësi që funksionon në nivel



<p>periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>institucionit, që monitoron standardet e cilësisë për të gjithë programet e studimit. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nga departamenti në baza të rregullta për qëllim të përpilimit të raportit të brendshëm të vlerësimit të programit përkatës që i nënshtrohet procesit të akreditimit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se për vlerësimin, institucioni përdor metodologji korrekte në drejtim të mbledhjes së të dhënave, si shqyrtim dokumentacioni, vlerësimin e komponentëve të përcaktuar në standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Format raportet, vlerësimi i dokumentacionit, vëzhgimi, intervistat gjysmë të strukturuar, fokus grupet janë disa nga metodat që janë përdorur për kryerjen e vlerësimit për këtë program studimi. Nuk ka ndonjë mekanizëm të veçantë kontrolli për këtë program studimi, formatet janë të njëjta për të gjithë programet e tjera të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Mbështetur në shqyrtimin e dokumenteve, bisedave me student të programit konstatohet se institucioni, përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga KSBC, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. GVJ nuk e të qartë se çfarë teste të standardizuara përdoren, të cilat janë të përmendur në raportin e vlerësimit. Përpos mekanizmave vlerësues të përmendur më sipër që vlejné për studentë, stafi më i ri akademik vëzhgohen nga eprorët apo nga drejtuesi i departamentit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojné në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Vihet re se institucioni realizon çdo semestër vlerësime duke përdorur disa metoda si vlerësimi i pedagogut nga studenti, monitorim të silabuseve, fedback nga studentët për ankesat si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra**



në vijim të tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka dy projekte relevante që janë në nivelin institucional projektet TEMPUS 'ENCHASE' dhe Erasmus+ QAINAL pasi këto projekte janë konkrete dhe ndërlidhen me rritjen e cilësisë duke përcjell përvoja nga vende të tjera. Përfshirja e aktorëve të brendshëm janë sqaruar në vlerësimin e standardeve të mësipërm, ndërsa në RVB përmendet prezenca e një eksperti të jashtëm, por nuk ka evidencë për të.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	KSBC përmes këtyre projekteve synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve koordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni i përbërë nga 6 anëtarë, të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, zv. Rektorja për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve sipas rastit.			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentet që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në raportin e vlerësimit të brendshëm përmenden 5 kritere në përzgjedhjen e individëve në këto komisione ose trupa: Kompetencat profesionale; Paanshmëria; Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe; Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it. Këto tipare sigurojnë objektivitet dhe shmangie të konfliktit të interesit.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Konstatohet se GVB është e përbërë vetëm nga anëtarë të brendshëm të departamentit dhe nuk ka përfshirje të ekspertit të jashtë në vlerësimin e cilësisë së brendshme.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi VI.5**

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Nga raporti i vlerësimit nuk është e qartë nëse raportet e monitorimit të cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Në funksion të transparencës do të ishin të nevojshme diskutimet me stafin dhe studentët, ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, çka do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nuk ka dëshmi nëse institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimit të cilësisë së brendshme.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në dokumentet e dorëzuara nuk ka ndonjë situatë konkrete kur rezultatet e vlerësimit kanë rezultuar me marrje masash konkrete në kuadër të programit të vlerësuar. Në raportin e vlerësimit përmenden trajnime didaktike për stafin që nuk lidhet drejtpërdrejtë me stafin e programit që vlerësohet.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni ka mekanizma të vlerësimit që janë të përqendruar me shumë në nivelin institucional dhe se ato mund të mos jenë aq të ndjeshme për të kuptuar nevojat për ndryshime në nivelin e programeve.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Konstatohet se institucioni ka ngritur disa mekanizma si takimet e rregullta me KSBC, senati, këshillimi i studentëve që mund të konsiderohen si mundësi për diskutim të cilësisë por mbeten të pa qarta format sesi bashkëpunohet në drejtim të përmirësimit të cilësisë në programin e studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	





**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Psikologji e Aplikuar” me profile, “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkollore”, “Psikologji Këshillimi”, “Psikologji Organizacionale”, “Menaxhim dhe vlerësim projektsh”, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. IAL dhe njësia bazë që ofron këtë program studimi demonstroi përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me kërkesat e tregut të punës përmes marrëdhënieve të konsoliduara me UET ALUMNI të punësuar dhe palë të tjera të interesuara.
2. Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me aktorë nga sfera publike dhe private që mundësojnë realizimin e praktikave profesionale.
3. Njësia bazë e ofrimit të masterit bën rishikimin e syllabuseve me inputin e dhënë nga pedagogët e lëndës dhe anëtarët e bordit të tregut të punës.
4. Studentët e këtij masterit profesional janë pjesëmarrës në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve prej tyre.
5. Dixhtalizimi i sistemit të të dhënave në ndihmë të infrastrukturës në mësimdhënie dhe mësimnxënie, ku stafi akademik dhe studentët kanë hapësirën e tyre personale në këtë sistem elektronik për hulumtime të mëtejshme akademike dhe jo vetëm.
6. Institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë për sa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit.
7. Infrastruktura fizike në funksion të realizimit të procesit mësimor.
8. Abonimi në bibliotekën online EBSCO&SAGE dhe COBISS Net.

**Pikat e dobëta:**

1. Ndryshimet e shpeshta të stafit akademik, të cilat vënë në rrezik qëndrueshmërinë e programit.
2. Konstatohet se fusha akademike-kërkimore e një pjese të personelit akademik të mos jetë në përputhje me programin e studimit.
3. Lëndët profilizuese të këtij programi janë vetëm tre, diferencim ky i pamjaftueshëm në kategorinë C të kurikulës për të shërbyer për thellimin e njohurive të studentëve në profilin që ata do të përzgjedhin, duke rrezikuar ta lënë atë në nivelin e njohjes së profilit të zgjedhur dhe konkurrencën e tyre në tregun e punës.
4. Studimi i tregut të punës rezulton të jetë empirik, më shumë sesa i ndërtuar mbi instrumente studimi real dhe mbetet i pjesshëm duke qenë se nuk prezanton nevojat për secilin profil me të njëjtën peshë. Pamundësia për të përshtatur riorganizimin e programit me nevojat e tregut të punës e bën të vështirë në këtë moment aplikimin e mëtejshëm të punësimit të studentëve në treg.



5. Marrëveshjet e praktikës për këtë program masteri vlerësohen të mos jenë të të njëjtës shkallë cilësie për secilin profil (sidomos profili organizacional dhe ai menaxhim dhe vlerësim projektsh).
6. Edhe pse janë organizuar disa trajnime profesionale nga institucioni për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, temat e trajnimeve nuk kanë qenë gjithëpërfshirëse për të 5 profilet që ky program ofron.
7. Literatura e cunguar në gjuhën shqipe dhe të huaj për mbulimin e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit sipas 5 profileve.

Rekomandimet e paraqitura më poshtë nga grupi i vlerësimit të jashtëm mbështeten te pikat e forta dhe mundësitë e institucionit, për të ndërhyrë dhe përmirësuar pikat e dobëta dhe pengesat në drejtim të konsolidimit dhe zhvillimit në linjë me standardet europiane të programit të studimit “Master profesional” në “Psikologji e aplikuar”, me profile: a. Psikologji klinike, b. Psikologji shkollore, c. Psikologji këshillimi, d. Psikologji organizacionale dhe e. Menaxhim dhe vlerësim projektsh:

#### Rekomandime:

1. Edhe pse konstatohet se përgjithësisht fusha akademike- kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, në disa përjashtime rekomandohet një vlerësim i kujdesshëm në këtë drejtim si dhe në ndarjen e ngarkesave mësimore këtij stafi
2. Rekomandohet që në syllabuset e lëndëve (ku është e aplikueshme) të parashikohen detyra praktike (aplikime në terren) me qëllim konkretizimin e njohurive dhe aftësimin e studentëve në kontekstin e profilit të zgjedhur prej tyre.
3. Rekomandohet që njohuritë që studenti merr gjatë këtij programi të thellohen dhe t’i japin mundësi atyre të konkurrojnë në tregun e punës dhe për këtë arsye nevojitet të rishikohen dhe përmirësohen disa syllabuse.
4. Rekomandohet rishikimi e përmirësimi i zhvillimit të praktikave në këtë program si një sfidë e tij, edhe pse institucioni bën përpjekje për të vendosur marrëdhënie bashkëpunime me institucione të ndryshme që mundësojnë realizimin e tyre. Këto marrëveshje mbeten të shtohen e të shkruhen në terma më konkretë për tu bërë më cilësore e të frytshme dhe që do të ndihmonin studentët e pesë profileve të këtij programi të njihen dhe angazhohen në profilin e përzgjedhur.
5. Rekomandohet që temat e trajnimeve të organizuara për studentët e këtij masteri të jenë më gjithëpërfshirëse duke përmbledhur të gjitha profilet që ky program ofron.
6. Shtim i bibliotekës me libra hardocopy sipas profileve të programit të studimit.
7. Rekomandohet që përmbyllja e studimeve të këtij MP të realizohet me anë të një dosjeje profesionale me qëllimin që studenti të zgjidhte përmes aftësive të tij të fituara situata konkrete në terren dhe jo hipotetike në provime.
8. Rekomandohet të përmirësohet përmbajtja e suplementit të diplomës ku të specifikohen profilet përkatëse të këtij programi studimi.
9. Rekomandohet edhe përfshirje të ekspertëve të jashtëm në vlerësimin e cilësisë së brendshme të këtij programi studimi.
10. Riaktivizimi i qendrës së shërbimeve psikologjike, si një formë e mirë për të lehtësuar përvojat e praktikës profesionale.



**Conclusions of the evaluation of second cycle study program “Professional Master in Applied Psychology”, with profiles: a. Clinical Psychology, b. School Psychology, c. Organizational Psychology, d. Counseling Psychology, e. Management and Project evaluation. of Higher Education Institution “European University of Tirana”.**

**Strengths and affirmations:**

1. The UET and the core unit that offers this study program demonstrate ongoing efforts to keep in touch with labor market demands through consolidated relationships with employed students UET ALUMNI and other stakeholders.
2. The institution has signed several cooperation agreements with public and private institutions and actors enabling the implementation of internships in this program.
3. The department reviews syllabuses with the input provided by lecturers and members of the labor market board.
4. Students of this master program participate in the periodic evaluation of teaching methods, knowledge assessment and evaluation of lecturer performance.
5. Digitalization of the data system is in support of the teaching and learning infrastructure, where academic staff and students have their own space in this e system for further academic research and not only/beyond.
6. The institution has a proper procedure in place for the whole process of examining, evaluating, announcing results and appealing by the student.
7. Physical infrastructure for the realization of the learning process.
8. Subscription to EBSCO & SAGE and COBISS Net online library.

**Weaknesses:**

1. Frequent changes of academic staff, which endanger the sustainability of the program.
2. It is found that the academic research field for some academic staff is not in accordance with the study program.
3. The syllabuses that differentiate the profiles of this program are only three and this differentiation is insufficient into category C of the curriculum with the intention to serve to deepen students' knowledge of the profile they will select, risking leaving it at the basic level recognition of the selected profile and competition in the labor market.
4. Labor market research turns out to be empirical, rather than built on real survey instruments, and remains partial as it does not present the needs for each profile with the same weight. The inability to adapt the program reorganization to the needs of the labor market makes it difficult at this time to further apply student employment in the market.
5. The internship arrangements for this master program are assessed not to be of the same quality degree for each profile (especially organizational profile, management and project evaluation).
6. Although some vocational training has been organized by the institution for graduated students in coordination with foreign employers, the training topics have not been inclusive for all the profiles that this program offers.



7. Limited literature in Albanian and foreign language to cover the study program subjects and modules according to 5 profiles.

The recommendations presented below by the external evaluation team build on the institution's strengths and opportunities to intervene and improve its weaknesses and obstacles in terms of consolidation and development in line with European standards of the study program Professional Master of Applied Psychology, with profiles: a. Clinical Psychology, b. School psychology, c. Counseling psychology, d. Organizational Psychology and e. Management and Project Evaluation:

**Recommendations:**

1. Although it is generally found that the academic-research area of the academic staff is in line with the study program, in some cases it is recommend a careful evaluation in this regard as well as the allocation of teaching loads to this staff during the academic year.
2. It is recommended that inside the subject syllabuses (where applicable) to be provide practical assignments (field applications) in order to concretize knowledge and to train students in the context of their chosen profile.
3. It is recommended that the knowledge the student receives during this program, to deepen and enable them to compete in the labor market and therefore some syllabuses need to be reviewed and improved.
4. It is recommended to review and improve the development of practices and internships in this program, although the institution is making efforts to establish cooperative relationships with various institutions that enable this realization. These agreements should to be enhanced and made more qualitative and fruitful, in order to help the students of this program enrolled in one of the five profiles to know and engage in the selected profile.
5. It is recommended that the topics of training organized for students of this master's program to be more inclusive by summarizing all the profiles that this program offers.
6. Adding in the library of hardcopy books according to study program profiles.
7. It is recommended that the graduation exam of the studies of this MP should be carried out by a professional file (portofolio) so the student would be able to solve real life problems/situations using the acquired skills.
8. It is recommended the improvement of the content of diploma supplement where all the profiles are specified on it.
9. It is also recommended to involve external experts in the evaluation of the internal quality report of this master program.
10. Re-activating the psychological services center as a good way to facilitate internship experiences.